

Cdo fëmijë në Shkollë

METODOLOGJIA PËR VLERËSIMIN E PRAKTIKAVE NË BAZË SHKOLLE PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË TRI MINISTRIVE, PËR FËMIJËT E ADOLESHENTËT JASHTË SISTEMIT ARSIMOR DHE NXËNËSIT NË RREZIK BRAKTISJEJE

Metodologjia për vlerësimin e praktikave në bazë shkolle, në kuadër të zbatimit të nismës ndërkombëtare “Çdo fëmijë në shkollë”, me vëmendjen e MAS, mbështetur nga UNICEF, zbatuar nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve

Stavri Llambiri



2015



Metodologjia realizohet në dobi dhe në interes të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, së bashku me strukturat e tjera vartëse.



Metodologjia mundësohet falë vëmendjes dhe mbështetjes së zyrës së UNICEF-it në Shqipëri.



Metodologjia u mundësua në bashkëpunimin me zyrën e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve, si pjesë e projektit "Çdo fëmijë në shkollë".

METODOLOGJIA PËR VLERËSIMIN E PRAKTIKAVE NË BAZË SHKOLLE PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË TRI MINISTRIVE, PËR FËMIJËT E ADOLESHENTËT JASHTË SISTEMIT ARSIMOR DHE NXËNËSIT NË RREZIK BRAKTISJEJE

QËLLIMI

1. Shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të disa shkollave:
 - a) në zbatimin e marrëveshjes së tri Ministrive për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë;
 - b) për trajtimin e nxënësve që:
 - (i) braktisin shkollën;
 - (ii) janë në rrezik braktisje.
 - c) për trajtimin e fëmijëve dhe adoleshentëve:
 - (i) gjysmë të dukshëm;
 - (ii) të padukshëm.
2. Identifikimi në shkollat e shqyrtuara i ndryshimeve njëvjeçare në praktikat e përmendura në pikën 1, bazuar në një bashkësi treguesish.
3. Grumbullimi i përvojave më të suksesshme të shkollave në pakësimin e numrit të fëmijëve jashtësistemit arsimor në rrezik braktisje dhe i vështirësive tipike që hasin këto shkolla.
4. Analiza e shkaqeve qëfëmijë dhe adoleshentë janë jashtë sistemit arsimor.
5. Formulimi i rekomandimeve për pakësimin e numrit tëfëmijëve jashtë sistemit arsimordhe në rrezik braktisje bazuar në propozimet e aktorëve në shkollat dhe gjetjet gjatë shqyrtimit të praktikave shkollore.

METODOLOGJIA

A. METODOLOGJIA E PËRZGJEDHJES SË SHKOLLAVE

I. Nivelet arsimore të shkollave

Shkollat e përfshira në projekt për vlerësimin e praktikave të përshkruara te Qëllimi, pika 1, u përkasin niveleve: a) fillor; b) arsimit të mesëm të ulët.

II. Bashkitë

Shkollat i përkasin bashkisë së Durrësit.

III. Numri i shkollave dhe përhapja e tyre

Numri i shkollave nuk do të formojë një kampionim bazuar në teorinë e statistikës matematike, por do të jetë i mjaftueshëm për gjetjet tipike të parashikuara te Qëllimi. Shkollat do t'u përkasin zonave urbane dhe atyre rurale. Do të marrin gjithsej në projekt 10 shkolla..

IV. Kushtet që duhet të përmbushin shkollat

Shkollat përzgjidhen në marrëveshje me DAR-et përkatëse, duke pasur parasysh qëçdo shkollë të përmbushë të paktën njëri prej kriterëve të mëposhtme dhe të gjitha

shkollat në bashkinë e Durrësit të mbulojnë të gjitha kriteret.

- a) Të kenë shqetësime të braktisjes së shkollës.
 - b) Të kenë nxënës që e kanë braktisur shkollën.
 - c) Të kenë fëmijë që nuk janë regjistruar kurrë në arsimin e detyrueshëm. (gjysmë të dukshëm të llojit të dytë, fëmijë të padukshëm) (Shihni përkufizimet në fund të Metodologjisë)
 - d) Të kenë nxënës me mungesa kronike të paarsyeshme.
 - e) Të kenë nxënës në rrezik braktisje të shkollës.
 - f) Të kenë fëmijë me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme.
- Është e rekomandueshme që të paktën disa nga shkollat të kenë përvoja si qendra komunitare.

B. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME PËR VLERËSIMIN NËBAZË SHKOLLE

I. Instrumentet e vlerësimit

Instrumentet që do të përdoren për vlerësimin e praktikave në bazë shkolle janë:

- Intervista
- Fokus grup

II. Aktorët e përfshirë në vlerësim

Aktorët e përfshirë në vlerësim janë:

- Drejtues të shkollave (drejtor, nëndrejtor)
- Mësues
- Përfaqësues nga qeveria e nxënësve
- Nxënës
- Psikolog, punonjës social.
- Prindër nga këshilli i prindërve të shkollës
- Përfaqësues të DAR-it
- Punonjës Policie
- Kryeplak
- Punonjës i gjendjes civile
- Drejtues/ staf nga Qendrat Shëndetësore
- Përfaqësues nga Prefektura

III. Vlerësuesit

“Vlerësues” është personi që:

- kryen një intervistë dhe shkruan zhvillimin e saj;
- moderon një fokus grup.

Vlerësuesi i intervistës

1. Vlerësuesi në një intervistë nuk duhet të japë përshtypjen se qëllimi i tij është të kontrollojë mirë-kryerjen e detyrave zyrtare. Nëse krijohet kjo përshtypje, ka gjasa që vlerësuesi të marrë të dhëna të shtrembëruara, pra, të pavlefshme për të. Vlerësuesi duhet t’i japë përshtypjen të intervistuarit se ai e çmon veçanërisht atë, përvojën e tij, idetë e tij, prandaj edhe e ka përzgjedhur për intervistë. Këto duhet t’ia thotë që në krye të intervistës.

2. Vlerësuesi duhet të dalë i siguar se e ka marrë informacionin që i duhet. Ai nuk duhet ta lerë intervistuesin të flasë jashtë fakteve.
3. Vlerësuesi duhet ta njohë shumë mirë dokumentacionin që i përket përmbajtjes së intervistës. Ai nuk duhet të largohet pa pyetje të tilla:
“Në këtë dokumentacion zyrtar thuhet Si e keni zbatuar ju këtë?” Nëse ai zbatimimi i dokumentacionit zyrtar kërkon një material të hartuar nga shkolla, kërkesa pasuese e vlerësuesit duhet të jetë: “A mund të ma tregoni materialin tuaj? Kjo do të ishte shumë e dobishme për mua dhe të tjerët?”
4. Vlerësuesi duhet t’i kërkojë të intervistuarit të tregojëdoemos ndonjë episod që i ka ndodhur dhe i ka bërë përshtypje për temat e intervistës si: braktisja ose mungesat e paarsyeshme ose puna me fëmijët me aftësi të kufizuara etj.
5. Gjatë intervistës duhet të jenë të pranishëm vetëm intervistuesi dhe i intervistuari dhe askush tjetër.
6. Është e këshillueshme që vlerësuesi i intervistës së prindërve të jetë gjithashtu prind, kurse i një nxënësi të arsimit bazë të jetë një nxënës i gjimnazit. Përvoja tregon se me këtë mënyrë të intervistuarit bisedojnë më hapur se sa vlerësuesit të jenë mësues ose të huaj të tjerë të rritur.
7. Raporti i intervistuesit përmban në krye emrin e shkollës, llojine të intervistuarit (nxënës, prindër, mësues etj.), datën e zhvillimit të intervistës dhe në fund, emrin e personit që ka kryer intervistën dhe firmën e tij.
8. Nëse drejtori i shkollës është i ri në këtë detyrë atij mund t’i kërkohej që të caktojë për intervistë njërin nga nëndrejtorët që ka punuar më gjatë në këtë detyrë.

Vlerësuesi i fokus grup (moderatori)

1. Moderatori paraqet qartë dhe miqësisht qëllimin e takimit. “Qëllimi i takimit është të diskutojnë bashkërisht për një çështje që është delikate dhe me vlerë për mbarëvajtjen e shkollës dhe të arsimit. Mendimet që do të shkëmbehen këtu do t’i shërbejnë këtij qëllimi.”
2. Përvoja tregon se shumë fokus grupe nuk arrijnë qëllimin pasi anëtarët e tij nuk janë motivuar nga moderatori që të parapërgatiten seriozisht. Ftesa për pjesëmarrje duhet të përmbajë pyetjet kryesore të takimit sa më të shtjelluara.
3. Moderator duhet të tërheqë mendimin e të gjithëve pjesëmarrësve (për këtë arsye numri i tyre duhet të jetë jo më shumë se 10 vetë)
4. Moderator duhet të sigurohet se e ka marrë informacionin që i duhet.
5. Kohëzgjatja e takimit nuk duhet të jetë më shumë se 90 minuta.
6. Një person tjetër mban hollësisht minutat e takimitose takimi incizohet.
7. Në raportin e një fokus grup nuk bëhet përmbledhje e mendimeve, por paraqiten të gjitha ato, qoftë edhe mendimi i një personi të vetëm, duke e theksuar këtë.
8. Raporti i moderatorit përmban në krye emrat e bashkisë, shkollës, emrat dhe lloji i pjesëmarrësve (nxënës, prindër, mësues etj.), datën e zhvillimit të takimit dhe në fund emri i moderatorit dhe mbajtësit të minutave dhe firmat e tyre.

Shënimi 1: Periudha e zhvillimit të intervistave dhe fokus grupeve nuk duhet të prekë kohën mësimore.

Shënimi 2: Intervistohen drejtorët e atyre shkollave që kanë më shumë nxënës braktisës ose/dhe që kanë mungesat më të mëdha për nxënës ose/dhe kanë hasur më shumë probleme në zbatimin e Udhëzimit 3-ministror ose/dhe kanë më shumë nxënës me aftësi të kufizuara se sa shkollat e tjera të bashkisë.

Shkollat e tilla paracaktohen në bashkëpunim me DAR-in përkatës.

Shënimi 3: Të paktën një ditë para se drejtori të intervistohet, ai pyetet se në cilat klasa:

a) braktisja është më e madhe; b) mungesat e nxënësve janë më të shumta; c) ka nxënës me aftësi të kufizuara. [Përgjigjja duhet të jetë e tillë: Klasa 6a dhe 7b ose 11b]

Shënimi 4: Është e dëshirueshme që drejtori i shkollës dhe mësuesit për çështjet e mësipërme a) dhe b) të shënimit 3 të intervistohen njëkohësisht.

Shënimi 5: Vlerësuesi dhe moderatori lipset të jenë vetë krijues në kryerjen e detyrës së tyre

C. BRAKTISJA E SHKOLLËS, NXËNËSIT NË RREZIK BRAKTISJE, MUNGESAT PA ARSYE TË NXËNËSVE, ZBATIMI I RREGULLORES SË 3 MINISTRIVE

I. DREJTORI I SHKOLLËS (intervistë)

Pyetjet 1

Braktisja e shkollës

1. Sa nxënës e kanë braktisur shkollën tuaj gjatë vitit të kaluar mësimor?
2. Sa përqind janë këta nxënës në shkollën tuaj? [Drejtori duhet ta dijë ose ta gjejë këtë sepse është një e dhënë që vendoset në planin vjetor të shkollës]
3. A keni nxënës që janë kthyer në shkollë pasi e kanë braktisur atë? Pse ka ndodhur kjo?
4. Cilët janë shkaqet kryesore që nxënësit braktisin shkollën te ju? [Rrumbullakosni një ose disa nga përgjigjet e mëposhtme të drejtorit dhe shkruani përgjigje të tjera që mund të shtojë ai.]
 - a) Nxënësit nuk jetojnë me prindërit biologjikë.
 - b) Nxënësit i përkasin një pakicë etnike.
 - c) Nxënësit kanë vështirësi të shkojnë në shkollë për shkak të largësisë së madhe nga vendbanimi.
 - d) Nxënësit kanë vështirësi në mësim.
 - e) Nxënësit kanë probleme të sjelljes.
 - f) Familjet e nxënësve kanë vështirësi ekonomike, prandaj djali u duhet si krahë pune.
 - g) Familjet e nxënësve ka shumë fëmijë prandaj u duhet vajza për t'u kujdesur për fëmijët e tjerë.
 - h) Paragjykime të prapambetura për vajzat.
 - i) Të tjera shto
5. Cilët janë nxënësit më në rrezik për të braktisur shkollën te ju? Rrumbullakosni një ose disa nga përgjigjet e mësipërme të drejtorit, te pika 4, dhe shkruani përgjigje të tjera që mund të shtojë ai.]
6. Cila është përvoja në shkollën tuaj për të parandaluar braktisjen e nxënësve?
7. Ju lutem, ndonjë episod që ju ka bërë përshtypje. (Kjo kërkesë e fundit i bëhet edhe mësuesit kujdestar, psikologut/punonjësit social etj. dhe për çdo temë “braktisja, mungesat, zbatimi i Rregullores së 3 ministrave etj.)

Pyetjet 2

Mungesat e paarsyeshme

1. Sa është përqindja e mungesave vjetore e të gjithë nxënësve kundrejt të gjitha orëve mësimore? [Drejtori duhet ta dijë ose ta gjejë këtë sepse është një e dhënë që vendoset në planin vjetor të shkollës]
2. Cila është përvoja e shkollës tuaj kur një nxënës mungon gjatë gjithë ditës?
3. Cila është përvoja e shkollës tuaj kur një nxënës largohet disa orë nga mësimet?

4. Cila është përvoja e shkollës tuaj për mungesat e paarsyeshme të nxënësve?
 [Shihni a i nje dhe a i zbaton i intervistuari nenin 89 të Dispozitave Normative (DN) Neni 89 thotë: 1) Mungesat e nxënësit janë të arsyeshme kur justifikohen me raport mjekësor ose prindi ka kërkuar leje paraprakisht dhe më pas ka paraqitur një shënim sqarues. 2) Prindi e paraqet arsyetimin për mungesat e fëmijë së tij te mësuesi përkatës kujdestar. Arsyetimet me shkrim të prindit ruhen nga mësuesi kujdestar për 1 (një) vit shkollor. 3) Mësuesi kujdestar ka të drejtë të vlerësojë si të arsyeshme/të paarsyeshme mungesa deri në dy ditë gjatë një muaji. Për mungesa më të gjata se dy ditë, vlerësimi bëhet me shkrim nga drejtori/nëndrejtori i shkollës dhe i dorëzohet mësuesit kujdestar. 4) Brenda javës së parë të çdo muaji, mësuesi kujdestar i dorëzon drejtorit/nëndrejtorit të shkollës tabelën e mungesave mujore të klasës, të ndara në: gjithsej, të arsyeshme, të paarsyeshme, mungesa 1-3 orëshe. 5) Drejtori/nëndrejtori përpilon tabelën e të dhënave mujore të shkollës dhe rendit klasat sipas dy treguesve: a) “Numri i mungesave për nxënës” e rrumbullakosur me një shifër pas presjes; b) “Përqindja e mungesave 1-3 orëshe kundrejt të gjitha orëve” e rrumbullakosur me një shifër pas presjes”. 6) Renditjet e klasave afishohen në një vend të dukshëm për nxënësit e shkollës. 7) Drejtorja e shkollës zhvillon mbledhje të posaçme për mungesat e nxënësve në tërësi ose për klasa të veçanta, sipas gjendjes së mungesave]
5. Cila është përvoja e shkollës tuaj për të parandaluar mungesat e paarsyeshme?
6. Si veproni me nxënësit e klasave I-III kur mungojnë për një periudhë në shkollë?
 [Shihni a i nje dhe e zbaton i intervistuari te DN, nenin 88/1]
 Neni 88/1 thotë: Kur nxënësi i klasave I-III, mungon për një periudhë të vitit mësimor, mësuesi: a) zbaton një program individual për nxënësin gjatë kohës që kthehet në shkollë; b) në bashkëpunim me prindërit, hartojnë planin e punës së prindërve me fëmijën gjatë periudhës që fëmija mungon në shkollë dhe gjatë pushimeve verore. Në fillim të vitit pasues, mësuesi vlerëson arritjen nga nxënësi të objektivave bazë të programeve lëndore të klasës paraardhëse, dhe, sipas rastit, vazhdon me program individual.

Pyetjet 3

Regjistrimi i nxënësve

1. Cila është përvoja e shkollës tuaj kur një nxënës nuk regjistrohet në klasën pasuese? (P.sh. ka mbaruar klasën e 7-të dhe duhet të regjistrohet në klasën e 8-të)
2. Cilat janë shkaqet kryesore që këta nxënës nuk regjistrohen?
 [Rrumbullakosni një ose disa nga përgjigjet e mëposhtme të drejtorit dhe shkruani përgjigje të tjera që mund të shtojë ai.]
 - a) Nxënësi e braktisi shkollën.
 - b) Nxënësi transferohet në një shkollë tjetër.
 - c) Familja e nxënësit transferohet në një vendbanim tjetër.
3. Cila është përvoja e shkollës tuaj kur një fëmijë nuk regjistrohet në klasën pasuese?

Pyetjet 4

Nxënësit me aftësi të kufizuara

1. Cila është përvoja juaj me Komisionin për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara (AK) në shkollë? Përse ka qenë dobishme kjo përvojë?
2. A i jeni drejtuar ndonjëherë Komisionit Multidisiplinar për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara (AK) pranë DAR/ZA-së? Nëse “PO” pse ka qenë e nevojshme për ju?
 [DN, Neni 93, 2: Komisioni, me kërkesën e ... drejtorit të (shkollës), ku fëmija është regjistruar, vlerëson nevojat arsimore e shoqërore të fëmijës dhe ecurinë e tij.
 DN, Neni 93, 10: Komisioni njofton me shkrim drejtorin e (shkollës) se cilët nga fëmijët me AK do të mësojnë me plan mësimor dhe programe lëndore të zakonshme, të përshtatura ose individuale.]

3. Si mësojnë te ju fëmijët me AK? [Përgjigjja duhet të jetë: Fëmijët me AK mësojnë me plan mësimor) dhe programe lëndore: a) të zakonshme; b) të përshtatura; c) individuale.]
4. Cilat janë përvojat e shkollës tuaj me nxënësit me AK? Sukseset, vështirësitë.

Pyetjet 5

Psikologu/punonjësi social

1. A është i rëndësishëm shërbimi psikologut/punonjësit social në shkollën tuaj? Ku më shumë është i dobishëm? Ku më pak?
2. Si konkretisht bashkëpunoni me të?

Pyetjet 6

Regjistrimi i fëmijëve në klasën e parë

[Zbatimi i Marrëveshjes së 3 Ministrive]

1. A e keni Rregulloren e firmosur nga 3 Ministrat për regjistrimin e nxënësve të klasës së parë?
2. A është e qartë ajo për ju?
3. Cila është përvoja e shkollës tuaj në zbatimin e kësaj Rregulloreje? Cilat janë vështirësitë që keni hasur?
4. Cilat janë përmirësimet që propozoni?
[- Drejtorët e shkollave, brenda 3 ditëve pune pas datës së fillimit të vitit shkollor, t'u dërgojnë njësisve arsimore përkatëse, në format elektronik dhe me shkresë zyrtare, listën emërore të fëmijëve që janë të regjistruar në klasën e parë, duke pasur parasysh përbërësit: Emri, i fëmijës mbiemri, emri i babait, emri i nënës, numri personal, gjinia, datëlindja, vendlindja dhe vendbanimi.]
- Mësuesit e shkollave publike përkatëse të merren me regjistrimin e fëmijëve të zonës së tyre që janë identifikuar nga punonjësi i policisë së zonës dhe personi përgjegjës i nënndarjes administrative.
- Drejtori i shkollës publike të njoftojë njësinë arsimore vendore përkatëse për efektivitetin e përpjekjeve për regjistrimin e këtyre fëmijëve.]

II. MËSUESI KUJDESTAR (intervista)

Shënim: Intervistohen mësues të filllores dhe mësues kujdestar të arsimit të mesëm të ulët.

Pyetjet 1

Braktisja e shkollës

1. Sa nxënës e kanë braktisur klasën tuaj gjatë vitit të kaluar mësimor?
2. A keni nxënës që janë kthyer në shkollë pasi e kanë braktisur atë? Pse ka ndodhur kjo?
3. Cilët janë shkaqet kryesore që nxënësit tuaj kanë braktisur shkollën?
(Rrumbullakosni një ose disa nga përgjigjet e mësuesit dhe shkruani përgjigje të tjera që mund të shtojë ai. Përgjigjet e mundshme të mësuesit janë po ato te “Drejtori i shkollës”, Pyetjet 1/ 4/a-i”.)
4. Cilët janë nxënësit tuaj më në rrezik për të braktisur mësimet?
(Rrumbullakosni një ose disa nga përgjigjet e mësuesit dhe shkruani përgjigje të tjera që mund të shtojë ai. Përgjigjet e mundshme të mësuesit janë po ato te “Drejtori i shkollës, Pyetjet 1/ 4/a-i”.)

5. Çfarë bëni ju në klasën tuaj që të parandaloni braktisjen e nxënësve?

Pyetjet 2

Mungesat e paarsyeshme

1. Si veproni ju kur një nxënës i klasës tuaj mungon gjatë gjithë ditës?
2. Si veproni ju kur një nxënës largohet disa orë nga mësimet?
3. Si veproni ju për mungesat e paarsyeshme të nxënësve?
[Shihni a i njeh dhe a i zbaton i intervistuari nenin 89 të DN. Ky nen është cituar i plotë te Drejtori i shkollës, Pyetjet 2/4]
4. Si i parandaloni ju mungesat e paarsyeshme në klasën tuaj?

Pyetjet 3

Regjistrimi i nxënësve

1. Si veproni ju kur një nxënës i klasës tuaj nuk regjistrohet në klasën pasuese? (P.sh. ka mbaruar klasën e 7-të dhe duhet të regjistrohet në klasën e 8-të)
2. Cilat janë shkaqet kryesore që këta nxënës nuk regjistrohen?
[Rrumbullakosni një ose disa nga përgjigjet e mëposhtme të mësuesit dhe shkruani përgjigje të tjera që mund të shtojë ai.]
 - a) Nxënësi e braktisi shkollën
 - b) Nxënësi transferohet në një shkollë tjetër.
 - c) Familja e nxënësit transferohet në një vendbanim tjetër.
 - d) Të tjera ...

Pyetjet 4

Nxënësit me AK

1. Sa nxënës me aftësi të kufizuara keni në klasën tuaj?
2. Çfarëlloj aftësish të kufizuara kanë nxënësit në klasën tuaj?
(Rrumbullakosin përgjigjen e mësuesit.)

Fëmijët me aftësi të kufizuara për nga lloji i aftësisë së kufizuar
1a. Të parit: nxënësi nuk ka vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë.
1b. Të parit: nxënësi ka disa vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë.
1c. Të parit: nxënësi ka shumë vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë
2a. Të dëgjuarit: nxënësi nuk ka vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë.
2b. Të dëgjuarit: nxënësi ka disa vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë.
2c. Të dëgjuarit: nxënësi ka shumë vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë.
3a. Aftësi motore të zhvendosjes së trupit (p.sh., ecja ose ngjitja e shkallëve): nxënësi nuk ka vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë..
3b. Aftësi motore të zhvendosjes së trupit (p.sh., ecja ose ngjitja e shkallëve): nxënësi ka disa vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë.
3c. Aftësi motore të zhvendosjes së trupit (p.sh., ecja ose ngjitja e shkallëve): nxënësi ka shumë vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë.
4a. Aftësi motore të lëvizjeve fine (p.sh., të shkruarit ose kopsitja e rrobave): nxënësi nuk ka

vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë..
4b. Aftësi motore të lëvizjeve fine (p.sh., të shkruarit ose kopsitja e rrobave): nxënësi ka disa vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë.
4c. Aftësi motore të lëvizjeve fine (p.sh., të shkruarit ose kopsitja e rrobave): nxënësi ka shumë vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë.
5a. Intelektuale: nxënësi nuk ka vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë..
5b. Intelektuale: nxënësi ka disa vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë.
5c. Intelektuale: nxënësi ka shumë vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë.
6a. Komunikimi (të kuptuarit dhe të kuptohesh nga të tjerët): nxënësi nuk ka vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë..
6b. Komunikimi (të kuptuarit dhe të kuptohesh nga të tjerët): nxënësi ka disa vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë.
6c. Komunikimi (të kuptuarit dhe të kuptohesh nga të tjerët): nxënësi ka shumë vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë.
7a. Sjellja dhe socializimi: nxënësi nuk ka vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë..
7b. Sjellja dhe socializimi: nxënësi ka disa vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë.
7c. Sjellja dhe socializimi: nxënësi ka shumë vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë.

3. Kush e ka përcaktuar llojin e AK të këtyre nxënësve?
4. A keni për ta mësues ndihmës?
5. Me çfarë programi mësojnë këta nxënës?
6. Si i mësoni këta nxënës?

Pyetjet 5

Psikologu/punonjësi social

3. A është i rëndësishëm shërbimi psikologut/punonjësit social në klasën tuaj? Ku është më shumë i dobishëm? Ku më pak?
4. Si konkretisht bashkëpunoni me të?

Pyetjet 6

Regjistrimi i fëmijëve në klasën e parë

[Zbatimi i Marrëveshjes së 3 Ministrive]

1. A keni dijeni për Rregulloren e regjistrimit të fëmijëve në klasën e parë të firmosur nga 3 ministra?
2. A keni marrë pjesë në zbatimin e saj? Si konkretisht?
3. Nëse “PO”, cilat janë vështirësitë keni hasur?

III. PSIKOLOGU/PUNONJËSI SOCIAL NË SHKOLLË (intervistë)

Intervistohen psikolog/punonjës/socialë që punojnë në arsimin bazë.

Pyetjet

1. Si punoni ju në këtë shkollë për të kryer detyrën tuaj?

2. Cilët ju vlerësojë më të dobishëm: a) drejtuesit e shkollës; b) mësuesit; c) nxënësit; ç) prindërit?
3. Me cilët keni më shumë sukses apo vështirësi, me: a) nxënësit; b) mësuesit; c) prindërit?
4. Me cilët keni më shumë sukses apo vështirësi, me nxënësit: a) që janë në rrezik të braktisin shkollën; b) që mungojnë pa arsye; c) që sillen keq me shokët/shoqet; ç) që abuzojnë me alkool, drogë d) që kanë vështirësi në të nxënë?
5. **(Përherë kërkoni të tregojnë ndonjë episod që i ka lënë mbresë gjatë punës së tij)**
[DN, Neni 46/1:Psikologu/punonjësi social ka këto detyra kryesore në institucionin arsimor: a) Në bashkëpunim me mësuesit dhe prindërit, identifikon e vlerëson, sa më herët, nxënësit me probleme të sjelljes ose me vështirësi në të nxënë, dhe harton e zbaton për këta nxënës plane individuale parandaluese ose rehabilituese. b) Ndihmon punonjësit arsimorë, prindërit dhe nxënësit në parandalimin ose eliminimin e abuzimeve të punonjësve arsimorë ndaj nxënësve, të nxënësve ndaj nxënësve dhe abuzimeve të vetë nxënësve nga duhani, alkooli, droga etj. c) Informon, nëpërmjet bisedave e leksioneve, punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimet moshore tipike të nxënësve dhe problemet tipike që nxënësit hasin gjatë të mësuarit dhe të nxënit. ç) Ndihmon mësuesit kujdestarë dhe mësuesit lëndorë për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në klasat e institucioneve arsimore të zakonshme. d) Këshillon nxënësit për karrierën e tyre. dh) Administron dhe interpreton teste psikologjike (nga psikologu). e) Plotëson dosjet individuale për rastet e nxënësve që kanë përfutuar nga shërbimi psiko-social. ë) Raporton me shkrim te drejtuesi i njësisë së shërbimit psiko-social çdo fakt për abuzim të nxënësve nga punonjës arsimor dhe prindër të nxënësit.]

IV. KRYETARI I QEVERISË SË NXËNËSVE BASHKË ME NJË ANËTAR TË SAJ(intervistë)

Pyetjet

1. Cilat janë dukuritë në shkollën tuaj që kanë shqetësuar më shumë Qeverinë e Nxënësve?
2. Nëse shkolla ka shqetësuese një ose më shumë nga dukuritë e shqyrtuara (braktisja, mungesat e paarsyeshme, mësimi i fëmijëve me AK, regjistrimi i nxënësve në përgjithësi dhe sidomos në klasën e parë), atëherë i drejtoni pyetje për secilën dukuri: Tregoni konkretisht si ka kontribuar Qeveria e Nxënësve në përmirësimin e braktisjes së nxënësve ose/dhe mungesat e paarsyeshme të nxënësve etj.

V. KRYETARI I KËSHILLIT TË PRINDËRVE TË SHKOLLËS DHE DY KRYETARË TË KËSHILLAVE TË PRINDËRVE TË KLASËS (intervistë)

Pyetjet

1. Cilat janë dukuritë në shkollën tuaj që kanë shqetësuar më shumë Këshillin e Prindërve?
2. Nëse shkolla ka shqetësuese një ose më shumë nga dukuritë e shqyrtuara (braktisja, mungesat e paarsyeshme, mësimi i fëmijëve me AK, regjistrimi i nxënësve në përgjithësi dhe sidomos në klasën e parë), atëherë i drejtohen pyetje për secilën dukuri: Tregoni konkretisht si ka kontribuar Këshilli i Prindërve në përmirësimin e këtyre dukurive.
[DN, 104, 4/c Këshilli i prindërve të klasës komunikon me prindër të nxënësve që rrezikojnë braktisjen e shkollës, ose mbetjen në klasë, ose që kryejnë shkelje të disiplinës]

VI. NXËNËS QË KA BRAKTISUR SHKOLLËN DHE ËSHTË KTHYERNË SHKOLLË (intervistë)

Pyetjet

1. Para ca kohësh ti e braktise shkollën. Pse u detyrove ta bësh këtë?
2. Tani je përsëri në shkollë. Si ndodhi kjo?
3. Kur u ktheve në shkollë, ke pasur disa vështirësi në mësimet që ke munguar. Si arrite ta marrësh veten?

VII. NJËSIA ARSIMORE VENDORE (intervistë)

(Intervista kryhet me titullarin e njësisë arsimore vendore ose me dikë të caktuar prej tij. Intervistuesi të ketë me vete Rregulloren e firmosur nga 3 Ministrat dhe ta njohë shumë mirë atë)

Pyetjet

1. Cila është procedura që ndiqni ju për të marrë informacion dhe raportuar për:
a) braktisjet nga çdo shkollë; b) mungesat e nxënësve të çdo shkolle; c) mungesat e paarsyeshme të çdo shkolle?
2. Cila është përvoja juaj në funksionimin e Komisioni Multidisiplinar për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara [Nëse përgjigjet se ende nuk është ngritur, pyeteni për vështirësitë që kanë hasur për ta ngritur.]
3. Cila është përvoja juaj me funksionimin e njësisë së shërbimit psiko-social? [Kjo Njësi ngrihet nga DAR/ZA]
4. Si veproni ju me shkollat që kanë përqindje të lartë të braktisjes në krahasim me shkollat e tjera të të njëjtit lloj?
5. Si veproni ju me shkollat që kanë shumë mungesa për nxënës në krahasim me shkollat e tjera?
6. Ka dalë një Marrëveshje e firmosur nga 3 Ministra dhe një Rregullore firmosur po prej tyre. Cila është përvoja juaj në zbatimin e tyre? A keni pasur vështirësi në zbatimin e tyre?

[Pjesë nga Rregullorja që i takon detyrave të njësisë arsimore vendore:

- Njësitë arsimore vendore, brenda datës 5 mars, të dërgojnë, me shkresë zyrtare, te qendrat përkatëse shëndetësore datën e fillimit të vitit të ardhshëm shkollor.
- Çdo njësi arsimore vendore, brenda datës 10 prill, me qëllim evidentimin e familjeve të fëmijëve që janë në rrezik të mos ndjekin klasën e parë: a) të bashkëpunojë me Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve në nivel lokal; b) të bashkëpunojë me të gjitha shkollat dhe grupet e tjera të interesit.
- Njësia arsimore vendore, brenda muajit maj, t'u dërgojë në format elektronik dhe me shkresë zyrtare, të gjitha shkollave në juridiksionin e saj, listën e parashikuar në pikën 8, të plotësuar me të dhënat e parashikuara në pikën 6.
- Çdo njësi arsimore vendore, bazuar në raportimet e shkollave sipas pikës 10, brenda 5 ditëve pune nga njoftimet e shkollave sipas pikës 10, të hartojë në format elektronik këto dokumente: Listën e fëmijëve të paregjistruar në klasën e parë, sipas zonës që i takon çdo shkolle të arsimit bazë në juridiksion; b) Listën e fëmijëve të paregjistruar në klasën e parë, sipas zonave që mbulojnë nënndarjet administrative përkatëse, sipas modelit të paraqitur te Shtojca; c) Listën e fëmijëve të paregjistruar në klasën e parë, sipas zonave që mbulojnë komisariatet përkatëse të policisë, sipas modelit të paraqitur te Shtojca.
- Çdo njësi arsimore vendore t'i dërgojë menjëherë, në format elektronik dhe me shkresë zyrtare, kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse dhe shefit të Komisarariatit

përkatës të Policisë dhe, për dijëni, Prefektit përkatës, listën e fëmijëve që ende nuk janë regjistruar në klasën e parë, të parashikuara në pikën 12/b, c dhe në Shtojcën me të dhënat për çdo fëmijë.

- *Çdo njësi arsimore vendore, brenda datës 15 tetor, t'u dërgojë, në format elektronik ose/edhe me shkresë zyrtare, shkollave që kanë raportuar fëmijë të paregjistruar, listën e fëmijëve me të dhënat e plotësuara nga përgjegjësi i njësisë së qeverisjes vendore dhe punonjësi i policisë së zonës dhe që i takojnë shkollës.*

FOKUS GRUPET

Fokus grupet kanë për qëllim që të hapen diskutime për të analizuar më thellëshkaqet e dukurive dhe, sidomos, për të nxjerrur propozime për përmirësimin e punës së shkollave. Nga këto propozime përfitojnë shkollat e bashkisë, DAR-i dhe specialistët që do të shkruajnë raportin përfundimtar të vlerësimit mbi praktikën në bazë shkolle.

Dy janë pyetjet themelore të moderatorit në çdo fokus grup:

- Cili është shkaku i kësaj dukurie?
- Si mund të përmirësohet kjo dukuri?

FOKUS GRUPI 1: BRAKTISJA E SHKOLLËS

Marrin pjesë drejtorët e shkollave – pilot ose një nëndrejtor i caktuar nga prej tyre, 3 mësues kujdestar (1 mësues i fillorës, dy mësues të arsimit të mesëm të ulët), dy përfaqësues nga qeveritë e nxënësve të dy shkollave dhe dy përfaqësues nga këshillat e prindërve në shkollat (Përfaqësuesit përzgjidhen nga intervistuesit ndër ata që u kanë rënë sy si më të aftë për të kontribuar në fokus grup.)

Çështjet që do të shqyrtohen janë dy:

- Pse ka ende nxënës që braktisin shkollën?
- Si mund të pakësohet braktisja e shkollës?

Në këtë fokus grup moderatori paraqet edhe idenë e dhënë nga eksperti në Raportin e Vlerësimit, maj 20115, për klasifikimin e nxënësve në rrezik braktisjeje.

- Nxënësi nuk jeton me prindërit biologjikë (1 pikë);
- Nxënësi i përket një pakicë etnike (1 pikë);
- Nxënësi ka vështirësi të shkojë për në shkollë për shkak të distancës së madhe ose për shkaqe të tjera (1 pikë);
- Nxënësi nuk ka ndjekur arsimin parashkollor (1 pikë);
- Nxënësi ka probleme të rënda të sjelljes ose sjellje anti-shoqërore (1 pikë);
- Familja e studentit merr asistencë sociale (1 pikë). (Ndryshe: Nxënësi jeton në rrethana të vështira dhe/ose ka probleme familjare në shtëpi (1 pikë)

Shënim i rëndësishëm: Shkollat-pilot do të duhet ta eksperimentojnë gjatë vitit mësimor këtë ide në disa nga klasat e çdo shkolle të caktuara nga drejtori i shkollës.

FOKUS GRUPI 2: MUNGESAT E PAARSYESHME TË NXËNËSVE

Marrin pjesë 3 nëndrejtorë të shkollave – pilot, 3 mësues kujdestar (1 mësues i fillorës, dy mësues të arsimit të mesëm të ulët), dy përfaqësues nga qeveritë e nxënësve të dy shkollave dhe dy përfaqësues nga këshillat e prindërve në shkollat (Përfaqësuesit përzgjidhen nga intervistuesit)

Çështjet që do të shqyrtohen janë tri:

- Pse ka ende nxënës që mungojnë paarsye?
- Pse ka nxënës që mungojnë një pjesë të orëve ditore të mësimin?

- Si mund të pakësohet numri i orëve të mungesave të paarsyeshme?

FOKUS GRUPI 3: FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Marrin pjesë një përfaqësues i njësisë arsimore vendore, drejtorët e shkollave – pilot, 3 mësues kujdestar që kanë në klasat e tyre nxënës me AK, një psikolog/punonjësi social, 3 prindër që kanë fëmijët e tyre me AK dhe ndjekin shkollat e zakonshme, kryetari i Komisionit Multidisiplinar për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara.

Çështjet që do të shqyrtohen janë tri:

- Pse ka fëmijë me aftësi të kufizuara që nuk e ndjekin shkollën e zakonshme, megjithëse janë të aftë ta bëjnë këtë?
- Si mund të shtohet numri i fëmijëve me AK që të ndjekin shkollën e zakonshme?
- Si mund të përmirësohet mësimi i nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme?

FOKUS GRUPI 4: ZBATIMI I RREGULLORES 3-MINISTRORE PËR NXËNËSIT E KLASËS SË PARË

Marrin pjesë një përfaqësues nga prefektura, drejtorët e shkollave, 2 punonjës policie të përfshirë në zbatimin e Rregullores dhe Shtojcës, 2 kryepaq të përfshirë në zbatimin e Rregullores dhe Shtojcës, 1 punonjës i gjendjes civile, 2 përfaqësues nga drejtuesit ose staf i iqendrave shëndetësore.

Çështjet që do të shqyrtohen janë dy:

- Cilat janë vështirësitë që janë hasur gjatë zbatimit të kësaj Rregulloreje?
- Si mund të zbatohet më mirë kjo Rregullore?

PËRKUFIZIME

FJSA: Fëmijët dhe adoleshentët jashtë sistemit arsimor.

Llojet e FJSA-së sipas vizibilitetit

FJSA të dukshëm: Quhen FJSA të dukshëm sepse mund të identifikohen duke përdorur SMIA. [(Sistemi për Menaxhimin e Informacionit të Arsimit). Si mund të identifikohen kështu?

FJSA gjysmë të dukshëm: Këta janë aktualisht FJSA të padukshëm që mund të bëhen të dukshëm përmes të dhënave qeveritare ndër-referenciale dhe kontrollit të regjistrimeve shkollore. Përbëhen nga dy grupet e mëposhtme:

- **Braktisësit e paregjistruar:** Fëmijët që e kanë braktisur shkollën, por që nuk janë regjistruar kurrë si të tillë, që mund të identifikohen duke përdorur rrjedhjen *vertikale* të informacionit nga shkolla në nivel kombëtar, në veçanti përmes përdorimit të regjistrimit të mungesave pa arsye në nivel nxënësi.
- **FJSA që nuk janë regjistruar kurrë në shkollë:** Fëmijët që nuk janë regjistruar kurrë në shkollë, por që informacioni për ta mund të mblidhet duke përdorur rrjedhën *horizontale* të informacionit ndër-sektorial. Regjistrimet për fëmijët mund të lidhen përmes një ID unike, siç është numri i certifikatës së lindjes, për të identifikuar ata që nuk janë regjistruar në bazën e të dhënave të Ministrisë së Arsimit, por që janë regjistruar në baza të tjera të dhënash, si regjistri civil dhe vendor.

FJSA të padukshëm: Këta janë FJSA që nuk janë të dukshëm në ndonjë të dhënë administrative të qeverisë ose në regjistrimet e shkollave, kështu që janë plotësisht të padukshëm. Në përgjithësi, ata përfaqësojnë fëmijët më vulnerabël dhe të disavatazuar.